



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria -Vlada-Government

Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural
Ministarstvo Poljoprivrede, Sumarstva i Ruralnog Razvoja
Ministry Of Agriculture, Forestry and Rural Development

Në mbështetje të nenit 93 pika (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, nenin 1.3 pika (d) të Rregullores së UNMIK-ut nr. 2001/19 të datës 13 shtator 2001 mbi Degën e Ekzekutivit të Institucioneve të Përkohshme të Vetëqeverisjes në Kosovë dhe nenit 23 Ligji Nr. 2004/13 për Materialin Fidanor, dt. 28 maj 2004,
Ministri i Ministrisë së Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural,
Nxjerr sa vijon:

UDHËZIM ADMINISTRATIV NR. 31/2008

Për regjistrimin dhe licencimin e pemishteve amë për mbishartesa dhe nënshartesa për pemë frutore dhe hardhi

Neni 1
Qëllimi

Me këtë Udhëzim Administrativ përcaktohen kushtet për regjistrimin dhe licencimin e pemishteve amë për mbishartesa dhe nënshartesa për pemë frutore dhe hardhi.

Neni 2

1. Kriteret për regjistrimin dhe licencimin e pemishteve amë për mbishartesa dhe nënshartesa, janë si në vijim:

- 1.1 të ngrihet në terrene që i përgjigjën kërkesave normale agronomike dhe sanitare të pastra nga nematodet dhe këpurdhat, e që kjo duhet të jetë e dokumentuar;
- 1.2. të ngrihet në terrene që nuk janë kultivuar në tri vitet e fundit kultura drunore dhe të jene të izoluara nga rrjedhja e ujërave sipërfaqësor;
- 1.3. ujërat për ujitje të pemishteve amë, duhet të jenë të pastra nga organizmat dëmtues.

Neni 3

Çdo prodhues është i obliguar të ketë planin e pemishtes amë për mbishartesa dhe nënshartesa për pemë frutore dhe hardhi.

Neni 4

1. Bimët në pemishten amë, duhet të jenë të numëruara në mënyrë progresive dhe të qëndrueshme.
2. Rreshtat, duhet të jenë të plotë dhe të ndarë për kultivarë, në rast se brenda një rreshti kultivohen kultivar të ndryshëm, është e detyrueshme ndarja e tyre me një hapësirë të dyfishtë.

Neni 5

Pemishtja amë për mbishartesa dhe nënshartesa, duhet të jetë e identifikuar sipas llojit dhe kultivarit me vendosjen e tabelës në fillim të çdo rendi.

Neni 6

Pronari i pemishtes amë për mbishartesa dhe nënshartesa për pemë frutore dhe hardhi është i obliguar të mbajë librin për mbajtjen e shënimeve mbi qarkullimin e materialit shumues, numrin e inspektimeve, përdorimin e produkteve për mbrojtje të bimëve.

Neni 7

Librat për mbajtjen e shënimeve të kërkuara nga neni 5 i këtij udhëzimi administrativ, do të përgatiten nga stafi profesional i Seksionit të Hortikulturës dhe Enti i Vreshtarisë dhe Verërave.

Neni 8

Pemishtja amë, duhet të pajiset me një zonë mbrojtëse, të paktën dhjetë metra distancë nga ngastrat fqinje si dhe duhet të mbahen të pastra nga bimësia spontane.

Neni 9

Jetëgjatësia e pemishteve amë

1. Pemishtja amë për mbishartesa mund të mbahet në fushë jo më shumë se 30 vjet nga momenti i mbjelljes së tyre.
2. Pemishtja amë për prodhim fare – për nënshartesa gjenerative mund të mbahet në fushë jo më shumë se 40 vjet nga momenti i mbjelljes së tyre.
3. Pemishtja amë për nënshartesa vegjetative mund të mbahet në fushë jo më shumë se 25 vjet nga momenti i mbjelljes së tyre.
4. Vreshti amë për mbishartesa mund të mbahet në fushë jo më shumë se 25 vite nga momenti i mbjelljes së tyre.
5. Vreshti amë për nënshartesa mund të mbahet në fushë jo më shumë se 25 vite nga momenti i mbjelljes së tyre.

Neni 10

Kriteret për marrjen e materialit shumëzues

1. Për grupin e pemëve farore, materiali shumëzues - sythat dhe kalemata, nga pemishtja amë për mbishartesa, duhet të merret pas vitit të tretë të mbjelljes.
2. Për grupin e pemëve bërthamore materiali shumëzues - sythat dhe kalemata, nga pemishtja amë për mbishartesa, duhet të merret pas vitit të pestë të mbjelljes.
3. Për hardhinë e rrushit, materiali shumëzues – kalemata, nga vreshti amë për mbishartesa, duhet të merret pas vitit të pestë të mbjelljes.
4. Për grupin e pemëve të imta: dredhëza, mjedra dhe manaferra, materiali shumëzues nga pemishtja amë, duhet të merret pas vitit të dytë të mbjelljes.

Neni 11

Pemishtet amë për mbishartesa dhe nënshartesa për pemë frutore dhe hardhi, duhet të mbrohen në mënyrë të vazhdueshme, për të mos lejuar zhvillimin e patogjenëve, parazitëve dhe barojave të këqija.

Neni 12

1. Në pemishten amë për mbishartesa dhe nënshartesa, duhet të eliminohen dhe asgjësohen të gjitha bimët e prekura nga sëmundjet dhe dëmtuesit karantinor si dhe mbeturinat bimore.
2. Të gjitha mjetet e punës në pemishten amë për mbishartesa dhe nënshartesa gjatë operacionit të krasitjes, duhet të dezinfektohen me mjete përkatëse dezinfektuese.

Neni 13

Kriteret për ngritjen e blloqeve sipas llojeve

1. Pemët për prodhim të farës për nënshartesë gjenerative, duhet të jenë të ngritura në blloqe të veçanta me program të veçantë trajtimi për të siguruar pastërti fitosanitare.
2. Pemët për prodhim të nënshartesave vegetative, duhet të jenë të ngritura në blloqe të veçanta me program të veçantë trajtimi për të siguruar pastërti fitosanitare.
3. Pemët për prodhim të mbishartesave - sythave dhe kalemave, duhet të jenë të ngritura në blloqe të veçanta me program të veçantë trajtimi për të siguruar pastërti fitosanitare.
4. Pemët për prodhim të materialit shumëzues për pemë të imta, duhet të jenë të ngritura në blloqe të veçanta me program të veçantë trajtimi për të siguruar pastërti fitosanitare.
5. Hardhitë për prodhim të materialit shumëzues për mbishartesa, duhet të jenë të ngritura në blloqe të veçanta me program të veçantë trajtimi për të siguruar pastërti fitosanitare.
6. Hardhitë për prodhim të materialit shumëzues për nënshartesa, duhet të jenë të ngritura në blloqe të veçanta me program të veçantë trajtimi për të siguruar pastërti fitosanitare.

Neni 14

Në pemishten amë për mbishartesa, pemët nuk duhet të kenë fruta.

Neni 15

Zbatimi

Mos zbatimi i këtij Udhëzimi Administrativ, sanksionohet me ndëshkimet e përcaktuara sipas nenit 21 të Ligji Nr. 2004/13 për Materialin Fidanor, dt. 28 maj 2004.

Neni 16

Hyrja në fuqi

Ky Udhëzim Administrativ hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Prishtinë, 15.10.2008

Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural
Ministri,
Prof. Dr. Idriz Vehapi
